



**UNIVERSITETI•
METROPOLITAN
TIRANA**

VLERËSIMI I CILËSISË SË PROCESIT TË MËSIMDHËNIES NË UMT

Semestri i parë

VITI AKADEMIK 2024 - 2025

Prill 2025

Raport

Mbi rezultatet e anketimit të studentëve të UMT-së për vlerësimin e procesit të mësimdhënies

Përgatitur nga:

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra e Kurrikulës dhe e Cilësisë pranë Universitetit Metropolitan Tirana

Periudha e realizimit të pyetësorit për semestrin e parë: Janar 2025,

Universiteti "Metropolitan Tirana"

web: www.umt.edu.al

Email: inf@umt.edu.al

1. QELLIMI DHE OBJEKTIVAT

Njesia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) në bashkëpunim me njesinë IT-së, zhvilluan anketimin e studentëve për mbledhjen e opinioneve lidhur me procesin mësimor gjatë semestrit të paë të vitit akademik 2024-2025.

Pyetësori për të vlerësuar opinionin e studentëve për procesin e mësimdhënies, u hartua dhe u përshtat për tju bashkëngjitur platformës "edu4school", duke bërë të mundur plotësimin e tij on-line nëpërmjet kësaj platforme. Plotësimi i këtij pyetësori është në të mirë të studentëve dhe të vetë institucionit, e ka plotësuar atë, pasi kontribuon në njohjen më të mirë, nga ana e drejtuesve me mendimin e tyre për mësimdhënien në Universitetin Metropolitan Tirana dhe të aspekteve të veçanta të funksionimit të tij.

Pyetësori përmban pyetje lidhur me të gjithë aktivitetin e pedagogëve gjatë procesit të mësimdhënies, të kontrollit të dijeve si dhe materialet mësimore që ju ofrohen studentëve. Rezultatet e përpunimit të pyetësorit, të cilat janë publikuar në këtë raport ndihmojnë, për të nxjerrë në pah vlerësimin e procesit të mësimdhënies nga ana e studentëve dhe për të adresuar problematikat e evidentuara.

Pyetësori i studentëve të UMT-së është një procedurë e përvitëshme që realizohet nga NJSBC me qëllim monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucionin tonë duke u fokusuar në indikatorë të përgjithshëm dhe specifikë të vlerësimit dhe monitorimit.

Ky sondazh që përgjithësisht realizohet çdo semestër ka disa objektiva madhore të cilat lidhen me mbledhjen e informacioneve periodike nga studentët për ecurinë e procesit mësimor, vlerësimin e provimeve të ndërmjetme dhe të praktikave profesionale që realizohen gjatë një viti akademik.

Informacionet e marra nga analiza e rezultateve nga ky sondazh, ndihmojnë vendimmarrjen e organeve drejtuese në përmirësimin e performancës së universitetit në drejtime të cilat sipas studentëve duhet të përformojnë më mirë si dhe shërbejnë për përpunime krahasuese nga viti në vit në lidhje me ecurinë e treguesve të ndryshëm të universitetit. Gjithashtu, këto rezultate u shërbejnë studentëve dhe maturantëve për të njohur më mirë UMT-në, nisur nga këndvështrimi i studentëve.

Për zhvillimin e këtij anketimi, NJSBC ka zbatuar disa akte të cilat janë orientuese dhe detyruese për institucionet e arsimit të lartë. Kështu, në hartimin e pyetësorit dhe të sondazhit është pasur parasysh politika e cilësisë në UMT, e cila bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 date 22.7.2015, Kreu X, Neni 103 "*Sigurimi i brendshëm i cilësisë*", në standardet dhe kriteret e cilësisë të programeve të studimit si pjesë e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Statutin e UMT-së, Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e NJSBC-së, ku në themel të të cilëve është monitorimi i vazhduar dhe sigurimi i cilësisë së programeve të studimit dhe i mësimdhënies.

2. METODOLOGJIA

Grumbullimi i të dhënave nga studentët në funksion të vlerësimit të procesit të mësimdhënies në UMT, u realizua nëpërmjet pyetësorit, bashkëngjitur në aneksin e këtij raporti, i cili u përgatit nga NJSBC. Pyetësori përmban 18 pyetje të fokusuara në 3 seksione, ku çdo pyetje ka 5 vlerësime. Pyetjet e çdo seksioni përseriten për të gjitha lëndët/pedagoget e semestrit.

Seksioni 1, mësimdhënia përmban 13 pyetje, të cilat fokusohen në aspekte të veçanta të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies nepermjet të cilave tentohet të mblidhet informacion mbi vlerësimin nga ana e studentit të lëndës dhe pedagogut përkatës.

Në 5 pyetjet e seksionit 2, që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të pedagogut gjatë kontrollit të dijeve, studentit i kërkohet të shprehet se deri në çfarë shkalle është dakort (Shumë dakort, Dakort, Neutral, Jo dakort, Aspak dakort) me pohimet që lidhen me aspekte të ndryshme të këtyre

aktiviteteve.

Në seksionin 3, në tre pyetjet e fundit i kërkohet studentëve të vlerësojnë për mbajtjen e lëndës dhe literaturën, që përdor pedagogu gjatë mësimdhënies.

Ndërsa me pyetjen në fund të pyetësorit i kërkohet studentëve të shprehen, nëse kanë ndonjë koment shtesë që dëshirojnë të ndajnë në lidhje me performancën e pedagogëve, përveç pyetjeve të mësipërme në pyetësor.

Përgjigjet e pyetësorëve janë përpunuar me metoda statistikore në formatin Excel duke i grupuar ato në tri grupe kryesore si me poshte në tabelën nr.2.1:

Tabela Nr.2.1.

Grupi	Përgjigjet e pyetjeve me vlerësim
"Të kënaqur"	"Shumë dakord" e "Dakord"
"Neutral"	"Neutral"
"Të pa kënaqur"	"Jo dakord" dhe "Aspak dakord"

Për vlerësimin e pedagogeve, vlerësimet e shkallëve të mësipërme janë konvertuar në nota sipas tabelës së më poshtëme nr.2:2

Tabela Nr.2.2

Vlerësimi	Shumë dakort	Dakort	Neutral	Jo dakort	Aspak dakort
Nota	5	4	3	2	1

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë grumbulluar në një periudhë 2 javore në muajt janar për semestrin e parë të këtij viti akademik.

Në vijim si po paraqesim rezultatet e përpunimit të pyetësorëve për secilin fakultet të Universitetit Metropolitan Tirana.

3. REZULTATET E PËRPUNIMIT TË PYETËSORËVE**3.1. Rezultatet e përpunimit të pyetësorëve për Fakultetin e Ekonomisë, Semestri I, Viti akademik 2024-2025**

Gjatë periudhës së anketimit në janar 2025 për semestrin e parë, në Fakultetin e Ekonomisë, pyetësorin e shpërndarë nëpërmjet platformës "edu4school" e kanë plotësuar, një numër studentësh si më poshtë shënuar në tabelën nr. 3.1

Tabela Nr. 3.1: Pjesëmarrja e studentëve në anketim në muajin janar 2025 (semestri i parë)

Nr.	Programet	Gjithësej	Përgjigjur	%
1	Bsc. Administrim Biznesi 1	15	12	80.00%
2	Bsc. Administrim Biznesi 2	21	14	66.67%
3	Bsc. Administrim Biznesi 3	17	14	82.35%
4	Bsc. Financë: me profile: "Kontabilitet", "Bankë"1	8	6	75.00%
5	Bsc. Financë: me profile: "Kontabilitet", "Bankë"2	7	5	71.43%
6	Bsc. Financë: me profile: "Kontabilitet", "Bankë"3	4	2	50.00%
7	Bsc. Informatikë Ekonomike (shqip) 1	42	40	95.24%
8	Bsc. Informatikë Ekonomike (shqip) 2	37	32	86.49%
9	Bsc. Informatikë Ekonomike (shqip) 3	20	16	80.00%
10	Bsc. Informatike Ekonomike (anglisht)1	22	17	77.27%
11	Bsc. Informatike Ekonomike (anglisht)2	21	18	85.71%
12	Bsc. Informatike Ekonomike (anglisht)3	11	7	63.64%
13	Msc. Ekonomik - MBA1	17	7	41.18%
14	Msc. Ekonomik - MBA2	15	9	60.00%
15	Msc. Menaxhim në inxhinieri1	11	8	72.73%
16	Msc. Menaxhim në inxhinieri2	9	7	77.78%
17	Msc. Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku1	23	20	86.96%
18	Msc. Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku2	21	14	66.67%
19	Msc. AI Business Analytics 1	20	19	95.00%
20	Master Prof. Marketing Dixhital	7	4	57.14%
21	Prog. Prof. Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente1	28	14	50.00%
22	Prog. Prof. Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente2	16	11	68.75%
	Totali FE	392	296	75.51%

Nga tabela nr.3.1 vërrejmë se në Fakultetin e Ekonomisë semestrin e parë nga 388 studentë të regjistruar në 22 programe studimore, kanë marrë pjesë në anketim 296 studentë, pra në masën 75.51% të numrit total prej 392 studentë të regjistruar


Nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë në platformën "edu4school" në semestrin e parë të vitit akademik 2024-2025, u vlerësuan **62** pedagogë, mësimdhënës në të gjitha programet mësimore të Fakultetit të Ekonomisë.

Nga përpunimi i të dhënave të grumbulluara, është përllogaritur vlerësimi nga studentët i çdo pedagogu në secilën lëndë që zhvillon në këtë semestër, mesatarisht me notë dhe në përqindje si dhe për secilin pedagog është përllogaritur një vlerësim mesatar për gjithë aktivitetin e tij në

mësimdhënie.

Në grafikun e mëposhtëm nr. 3.1, jepet numri i pedagogëve që janë vlerësuar sipas një shkalle të caktuar vlerësimesh.

Grafiku Nr. 3.1: Vlerësimi mesatar i pedagogëve mësimdhënës në semestrin e parë



Kështu nga numri total **62** i pedagogëve, që kanë dhënë mësim në semestrin e parë, **2 pedagogë** janë vlerësuar nga 3.11 - 3.41, **4 pedagogë** vlerësohen nga 4.01 – 4.31, **16 pedagogë** nga 4.31 – 4.61, **32 pedagogë** nga 4.61 – 4.91, **7 pedagogë** 4.72 – 4.92 dhe **8 pedagogë** mbi 4.91.

3.2. Rezultatet e përpunimit të pyetësorëve për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, Semestri I, Viti akademik 2024-2025

Gjatë periudhës së anketimit në janar 2025 për semestrin e parë, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, pyetësorin e shpërndarë nëpërmjet platformës "edu4school" e kanë plotësuar, një numër studentësh si më poshtë shënuar në tabelën nr. 3.2

Tabela Nr. 3.2: Pjesëmarrja e studentëve në anketim në muajin janar 2025 (semestri i parë)

Nr.	Programet	Studentë Gjithësej	Përgjigjur	%
1	Bsc. Arkitekture 1	21	12	57.14%
2	Bsc. Arkitekture 2	29	24	82.76%
3	Bsc. Arkitekture 3	22	17	77.27%
4	Bsc. Arkitekture 4	21	16	76.19%
5	Bsc. Arkitekture 5	27	16	59.26%
6	Bsc.Inxhinieri Ndertimi 1	36	22	61.11%
7	Bsc.Inxhinieri Ndertimi 2	48	32	66.67%
8	Bsc.Inxhinieri Ndertimi 3	65	31	47.69%
9	Msc. Inxhinieri Ndertimi, strukture dhe infrastrukture 1	84	57	67.86%
10	Msc. Inxhinieri Ndertimi 2, infrastrukture	4	2	50.00%
11	Msc. Inxhinieri Ndertimi 2, strukture	48	41	85.42%
12	Program profesional-Topo GIA 2	8	6	75.00%
13	Program profesional-Grafik Dizajn 1	33	18	54.55%
14	Program profesional-Grafik Dizajn 2	24	12	50.00%
	Totali FIA	470	306	65.11%


Nga tabela nr.3.2 vërrejmë se në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, semestrin e parë nga 470 studentë të regjistruar në 14 programe studimore, kanë marrë pjesë në anketim 306 studentë, pra në masën 65.11% të numrit total të studentëve.

Nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë në platformën "edu4school" në semestrin e parë të vitit akademik 2024-2025, u vlerësuan **56** pedagogë, mësimdhënës në të gjitha programet mësimore të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës.

Nga përpunimi i të dhënave të grumbulluara, është përllogaritur vlerësimi nga studentët i çdo pedagogu në secilën lëndë që zhvillon në këtë semestër, mesatarisht me notë dhe në përqindje si dhe për secilin pedagog është përllogaritur një vlerësim mesatar për gjithë aktivitetin e tij në mësimdhënie.

Në grafikun e mëposhtëm nr. 3.2, jepet numri i pedagogëve që janë vlerësuar sipas një shkalle të caktuar vlerësimesh.

Grafiku Nr. 3.2: Vlerësimi mesatar i pedagogëve mësimdhënës në semestrin e parë



Kështu nga numri total **56** i pedagogëve, që kanë dhënë mësim në semestrin e parë, **2 pedagogë** janë vlerësuar nga 3.1 - 3.72, **5 pedagogë** nga 3.72 – 4.34, **46 pedagogë** vlerësohen nga 4.34 – 4.96, dhe **2 pedagogë** mbi 4.96.

3.3. Rezultatet e përpunimit të pyetësorëve për Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT, Semestri I, Viti akademik 2024-2025

Gjatë periudhës së anketimit në janar 2025 për semestrin e parë, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT, pyetësorin e shpërndarë nëpërmjet platformës "edu4school" e kanë plotësuar, një numër studentësh si më poshtë shënuar në tabelën nr. 3.3

Tabela Nr. 3.3: Pjesëmarrja e studentëve në anketim në muajin janar 2025 (semestri i parë)

Nr.	Programet	Studentë Gjithësej	Përgjigjur	%
1	Bsc.Inteligjence artificiale 1	12	11	91.67%
2	Bsc.Inteligjence artificiale 2	7	7	100.00%
3	Bsc.Inxhinieri Elektrike 1	35	29	82.86%
4	Bsc.Inxhinieri Elektrike 2	21	20	95.24%
5	Bsc.Inxhinieri Elektrike-3	13	7	53.85%
6	Bsc.Inxhinieri Kompjuterike 1	49	46	93.88%
7	Bsc.Inxhinieri Kompjuterike 2	32	28	87.50%
8	Bsc.Inxhinieri Kompjuterike 3	55	42	76.36%
9	Bsc.Software Engineering 1	53	48	90.57%
10	Bsc.Software Engineering 2	44	38	86.36%
11	Bsc.Software Engineering 3	49	41	83.67%
12	Program profesional-Dizajn software 1	33	26	78.79%
13	Program profesional-Dizajn software 2	21	16	76.19%
14	Msc. Inxhinieri elektrike 1	21	16	76.19%
15	Msc. Inxhinieri elektrike2-Automatizim industrie	7	7	100.00%
16	Msc. Inxhinieri elektrike2- Energjitike	18	14	77.78%
17	Msc. Inxhinieri Informatike 1	10	7	70.00%
18	Msc. Inxhinieri Informatike 2	6	6	100.00%
19	Msc. Inxhinieri software 1	9	7	77.78%
20	Msc. Inxhinieri software 2	11	1	9.09%
21	Msc.Inteligjence artificiale	19	17	84.47%
	Totali FSHKIT	525	434	82.67%

Nga tabela nr.3.3 vërrejmë se në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT, semestrin e parë nga 525 studentë të regjistruar në 21 programe studimore, kanë marrë pjesë në anketim 434 studentë, pra në masën 82.67% të numrit total të studentëve.


Nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë në platformën "edu4school" në semestrin e parë të vitit akademik 2024-2025, u vlerësuan 48 pedagogë, mësimdhënës në të gjitha programet mësimore të Fakultetit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT.

Nga përpunimi i të dhënave të grumbulluara, është përlogaritur vlerësimi nga studentët i çdo pedagogu në secilën lëndë që zhvillon në këtë semestër, mesatarisht me notë dhe në përqindje si dhe për secilin pedagog është përlogaritur një vlerësim mesatar për gjithë aktivitetin e tij në mësimdhënie.

Në grafikun e mëposhtëm nr. 3.3, jepet numri i pedagogëve që janë vlerësuar sipas një shkalle të

caktuar vlerësimesh.

Grafiku Nr. 3.3: Vlerësimi mesatar i pedagogëve mësimeve në semestrin e parë



Kështu nga numri total **48** i pedagogëve, që kanë dhënë mësime në semestrin e parë, **1** pedagog është vlerësuar nga 3.1 - 3.43, **5** pedagogë vlerësohen nga 3.76 – 4.09, **15** pedagogë nga 4.09 – 4.42, **21** pedagogë nga 4.42 – 4.75 dhe **6** pedagogë mbi 4.75

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga analiza e rezultateve të anketimit konstatohet se:

- Në Fakultetin e Ekonomisë **semestrin e parë** nga 392 studentë të regjistruar në 22 programe studimore, kanë marrë pjesë në anketim 296 studentë, ose 75.51% të numrit total të studentëve.
- Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, **semestrin e parë** nga 470 studentë të regjistruar në 14 programe studimore, kanë marrë pjesë në anketim 306 studentë, ose 65.11% të numrit total të studentëve.
- Në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT, **semestrin e parë** nga 525 studentë të regjistruar në 21 programe studimore, kanë marrë pjesë në anketim 434 studentë, ose 82.67% të numrit total të studentëve.
- Në rang Universiteti në **semestrin e parë**, kanë marrë pjesë në anketim 1036 studentë nga 1387 të regjistruar, ose rreth 74.69 % e numrit total të studentëve të regjistruar. (tabela Nr. 4.1)

Tabela Nr. 4.1: Pjesëmarrja e studentëve në anketim në muajin janar 2025, sipas fakulteteve dhe në nivel universiteti, semestri i parë, viti akademik 2024-2025

Nr.	Fakultetet	Studentë Gjithësej	Përgjigjur	%
1	Fakulteti i Ekonomisë	392	296	75.51%
2	Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës	470	306	65.11%
3	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT	525	434	82.67%
4	Universiteti metropolitar Tirana	1387	1036	74.69%

Rezultatet tregojnë se studentët janë të kenaqur me aktivitetin e pedagogëve në të tria aspektet e kërkuara si gjatë procesit mësimor, kontrollit të dijeve ashtu dhe në përdorimin e literaturës dhe vlerësimi përfundimtar i tyre tregon se:

- Rreth 97 % e pedagogëve të Fakultetit të Ekonomisë, në tërë veprimtarinë e tyre akademike, vlerësohen nga studentët me notë mbi 4.
- Rreth 95 % e pedagogëve të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në tërë veprimtarinë e tyre akademike, vlerësohen nga studentët me notë mbi 4.
- Rreth 92 % e pedagogëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT, në tërë veprimtarinë e tyre akademike, vlerësohen nga studentët nga studentët me notë mbi 4.

Në lidhje me pyetjen nëse kanë ndonjë koment shtesë që dëshirojnë të ndajnë në lidhje me performancën e pedagogëve, përveç pyetjeve të mësipërme, pothuajse të gjithë studentët nuk kanë komente shtesë, ndërsa komentet e pakta që janë bërë shprehin vlerësime pozitive për pedagogët.

Theksomë se të dhënat e këtij sondazhi do të gërshetohen edhe me të dhëna nga forma të tjera të vlerësimit të stafit akademik, për të patur një vlerësim sa më objektiv për secilin prej anëtarëve të stafit akademik.

ANEKS

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PEDAGOGUT NGA STUDENTËT

Lënda: _____

Programi: _____

Fakulteti: _____

Pedagogu: _____

Viti akademik: _____

Ju lutemi vlerësoni pedagogun e lëndës duke zgjedhur një nga numrat nga 1 deri në 5, ku 1 tregon vlerësimin më të ulët dhe 5 vlerësimin më të lartë, për secilin nga aspektet e mëposhtme:

Nr.	Performanca e përgjithshme	Vlerësimi				
	Pedagogu gjatë mësimdhënies:					
1	Në fillim të semestrit, prezanton sylabusin e lëndës, duke sqaruar objektivat dhe pritshmëritë kryesore.	1	2	3	4	5
2	Demonstron përgatitje profesionale për çdo seancë mësimore	1	2	3	4	5
3	Ndjek rregullisht procesin mësimor dhe menaxhon me efikasitet kohën e mësimi	1	2	3	4	5
4	Siguron autoritet dhe disiplinë në klasë gjatë zhvillimit të orës së mësimi	1	2	3	4	5
5	Shpjegon qartë dhe kuptueshëm	1	2	3	4	5
6	Nxit interesin dhe angazhimin e studentëve për lëndën	1	2	3	4	5
7	Përdor shembuj të përshtatshëm për të lehtësuar kuptimin e tematikës së lëndës	1	2	3	4	5
8	Organizon teste, detyra dhe ese, duke ndihmuar studentët në përvetësimin më të thelluar të lëndës	1	2	3	4	5
9	Materialet mësimore janë të strukturuar qartë, të mjaftueshme dhe të dobishme për procesin e të nxënit	1	2	3	4	5
10	Detyrat e kursit janë të menduara për të nxitur të menduarit kritik dhe për të përforcuar përvetësimin e lëndës nga studentët	1	2	3	4	5
11	Inkurajon dialogun, duke i ftuar studentët të bëjnë pyetje dhe duke iu përgjigjur në mënyrë të plotë dhe profesionale	1	2	3	4	5

Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së procesit të mësimdhënies në UMT, Semestri i Parë, 2024-2025

12	Shfaq gatishmëri për të ndihmuar studentët sa herë kanë nevojë edhe jashtë orarit të rregullt të mësimin	1	2	3	4	5
13	Ka komunikim profesional dhe etik me studentët	1	2	3	4	5
Pedagogu gjatë vlerësimit:						
14	Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe të njohura për studentët	1	2	3	4	5
15	Kërkon detyra dhe harton pyetje në përputhje me programin mësimor	1	2	3	4	5
16	Garanton barazi dhe objektivitet në procesin e vlerësimit për të gjithë studentët	1	2	3	4	5
17	Ndërmerr masa të qarta dhe efektive për të parandaluar kopjimin dhe plagjiaturën gjatë procesit të vlerësimit	1	2	3	4	5
18	Publikon rezultatet brenda afatit të përcaktuar kohor	1	2	3	4	5
Lënda që vlerësoni:						
19	Lënda ndihmon në formimin profesional të studentëve	1	2	3	4	5
20	Përmbajtja është e lidhur me lëndët e tjera të programit	1	2	3	4	5
21	Literatura mbështetet në tekste bashkëkohore dhe burime të përditësuara	1	2	3	4	5

A ka ndonjë koment shtesë që dëshironi të ndani në lidhje me performancën e pedagogut, përveç pyetjeve të mësipërme?
